5 N...

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1.1(3Δ)

Tirane, 5 Nentor 1937 L 1412

I ndershem e i dashur Im Ungj.

Kam marre letren t'uaj, ka pak dit dhe po pergjigjem pasi prita te permblidhnja pergjigjet e kerkuara. Nuk do t'ju pergjigjem ne "qortimet" se e shoh qe jini merzitur shume me çeshtjet e medha dhe nuk esht e udhes qe te shikojme vogelsirat. Vetem do t'ju shpiegohem per "Listen e fameshme qe kerkonit nga "Argus" se kur me shkrojte une dyke kujtuar se deshite Katalog (se ate pashe qe muarte dhe nuk dinja se kishit marre edhe fature te librave qe blete, as qe m'a shpiegonit kete) e bleva me kohe dhe e mbajta pastaj ca dit se mejtova qe nuk do t'ish gje e nguteshme. Tashi u-kujdesa me nje here po perfat te keq nuk me dhane t'ua dergonj; thane qe s'kane mbajtur kopje, ate qe shkrojtne ua dhane dhe shtojne se çmimet e librave i gjeni te shenuara prapa secilit libri; po te dosani. Sa per librin t'uaj, ato qe kane marre nga Selenku i kishin, thote, nga Libraria "Mademoiselle Chimchki" dhe nuk njohin nonje Triandafilidhin; asaj ia kane derguar llogarine per nj'a 7 cope te shitura, thote dhe s'e gjen te nevojshme qe t'u jape juve tjeter llogari. Persërit edhe nje here se une ~~pertesen~~ nuk e njoh dhe tregohem me gjisht ketu per kujdesin qe kam ne punet si edhe per çdo njeri qe me ka kerkuar nonje sherbim s'jam kursyer kurre te benj ate qe kam patur ne dore. Do t'ish gje e pakuptuarshme qe te pertonja per punet t'uaja, se s'kam per asnje njeri tjeter ate nderim dhe simpathi e mirenjohje sa kam per Juve; por ne gofte se qelluan raste qe s'ju kenaqa dot, s'kam ç'benj; por me duket se jane me teper fjale te nxjerra ne çaste nervoziteti se sa per arsye me themel. Sa per punet e tjera, beni ashtu siç e shihni me t'arsyeshme. Z. Naçi ia dorezova letren; ju dergon te fala dhe simpathira e keshillon me teper durim.

Nga familja ime kini nderimet me te thella.

Ju puthinë doren
Nipi juaj
Vasili

Per Gegin u-gezuam shume qe e shpetoi Zoti.
Te fala tere miqve.

"Bisedime te Parlamentit", siç ju shenova edhe nje here, nuk kane numra te veçanta per plotesim, ato qe kishin ato me dhane; e vetmja shpresë esht qe t'i rishtypin tani serine, po kush e di kur do vije ajo dite. Fletoren Zyrtare s'ma kane dhene akoma; me jane zotuar per keto dite..

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ